

V E N D I M
Nr.490 datë 18.10.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.273, DATË 12.6.1993 "PËR RRITJEN E ÇMIMEVE TË BUKËS MASIVE DHE TË
MIELLIT"

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrisë së Tregtisë e të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.273, datë 12.6.1993, në pikën 1, paragrafi i parë, fjalët "... ndryshohen përkatësisht si vijon:", bëhen : "... ndryshohen në çmime maksimale (tavan) përkatësisht si vijon:".

2. Në pikën 3, paragrafi i parë, fjalët "... si edhe marzhet e .." bëhen: "... si dhe marzhet maksimale të... "

3. Paragrafi i fundit i pikës 1 dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

4. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, nxjerrin udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi